



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 20.11.2018

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR.1 TË MARRËVESHJES SË HUAS TË DATËS 31.12.2012, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (EBRD), PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË PËRMIRËSIMIT TË SIGURISË SË DIGËS NË HIDROCENTRALIN E KOMANIT, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.103/2013”

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e **komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese Nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin Nr.103/2013”.

Në mbledhjen e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë.

Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes ndryshuese Nr.1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin Nr.103/2013.

Marrëveshja ndryshuese vjen pas realizimit në masën 100 % të të gjithë aktiviteteve të parashikuara në marrëveshjen fillestare dhe synon që fondi i mbetur nga kredia e akorduar të përdoret për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe remontit në HEC-in Koman, si një bashkëfinancim me EBRD, aktivitet i cili nuk ka qenë i përfshirë në marrëveshjen bazë.

Qëllimi i projektit është që të ndihmojë huamarrësin në financimin e programit të investimit të njësisë së projektit për:

- a) Zonën e grykës së digave dhe pastrimit të digës së hidrocentralit të Komanit ;
- b) Masat e mbrojtjes së shkëmbinjve ;
- c) Rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Komanit, i cili synon forcimin e sigurisë së digave në hidrocentralin e Komanit, në Shqipëri.

Projektligji vjen pas miratimit në parim të ndryshimit të marrëveshjes së huas me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.529, datë 11.9.2018, dhe ka për qëllim ratifikimin e ndryshimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të nënshkruar prej palëve.

Marrëveshja parashikon:

- Zëvendësimin e të dhënave që përfshihen në skedulet 1 e 2, të marrëveshjes së huas, me skedulet 1 e 2, të marrëveshjes ndryshuese nr 1, ku synohet:
- Përdorimi i pjesës së kredisë së mbetur pa përdorur me vlerë 6 128 224 euro, për realizimin e aktiviteteve shtesë të projektit.
- Shtyrja e afatit të përfundimit të projektit, si dhe e afatit të përdorimit të fondeve të kredisë deri më 31.12.2021, me qëllim mundësimin e investimeve të shtuara në projekt.
- Zëvendësimin e emërtimeve “Ministria e Financave” dhe “Ministri i Financave” me emëritmet “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” dhe “Ministri i Financave dhe Ekonomisë”, përgjatë tekstit të marrëveshjes.
- Ndryshimin e adresës së huamarrësit sipas vendodhjes aktuale.

Efektet financiare

Projekti është pjesë e parashikimeve buxhetore të KESH, sha për periudhën 2018-2020. Marrëveshja ndryshuese nuk parashikon financime shtesë, por konsiston thjesht në përdorimin e fondeve të mbetura për të realizuar investime të tjera shtesë.

Diskutime në Komision

Përfaqësuesit e ministrive, pasi shpjeguan në mënyrë të detajuar projektligjin dhe përmbajtjen e marrëveshjes, dhanë shpjegime edhe mbi pyetjet e deputetëve sa i takon efekteve financiare dhe afateve të marrëveshjes.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm dhe e miratoi atë.

KRYETARE

MIMI KODHELÏ